

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për pacientin

ADVIT

Tretësisirë me pika për gojë -
(10.000 UI + 10.000 UI) / mL
(Vitaminë A + Vitaminë D)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Advit dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Advit
3. Si ta merrni Advit
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Advit
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË ADVIT DHE PËRSE PËRDORET

Advit ka në përbërjen e tij vitaminë A (retinol) dhe vitaminë D (ergokalçiferol). Vitamina A është e domosdoshme për rigjenerimin e rodopsinës së retinës, për formimin normal të epitelit dhe për rritjen. Pamjaftueshmëria e vitaminës A mund të shkaktojë verbim, hiperkeratozë dhe metaplazi të mukozës, e cila bëhet më e ndjeshme ndaj infeksioneve. Vitamina D rregullon metabolizmin normal të kalciumit dhe fosforit dhe parandalon e mjekun rakinin. Vitaminat A dhe D janë të tretshme në yndyrma. Ato përthithen nga aparati tretës në masën rreth 80%, kurse përthithja e dozave më të larta është më e ulët. Përthithja varet nga kripërat biliare. Advit përdoret për parandalimin dhe mjekimin e pamjaftueshmërisë së vitaminave A dhe D.

2. PËRPARA SE TË MERRNI ADVIT

Mos merrni Advit në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj vitaminave A dhe D ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Advit;
- jeni me hiperkalçemi.

Tregoni kujdes të veçantë me Advit

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Advit. Për të parandaluar mbidozimin e vitaminës A dhe D, duhet të kihet parasysh sasia e këtyre vitaminave që foshnjat e marrin me qumështin e gjirit ose me qumështin e posaçëm për fëmijë. 100 mL qumësht nëne përmbajnë 200 UI vitaminë A dhe 10 UI vitaminë D. E njëjta sasi qumështi lope përmban 80 UI vitaminë A dhe 10 UI vitaminë D. Tipat e ndryshëm të qumështit të posaçëm për fëmijë përmbajnë sasi të ndryshme të këtyre vitaminave. Sasia e këtyre vitaminave shënohet në fletët e posaçme që shoqërojnë qumështin e përgatitur për fëmijë.

Vitamina A duhet të përdoret me kujdes në pacientë me sëmundje të mëlçisë. Ajo duhet të përdoret me kujdes tek fëmijët, të cilët mund të jenë më të ndjeshëm ndaj efekteve të saj, tek pacientët me sistem renal të dëmtuar, ose me sëmundje kardiake dhe tek pacientët të cilët mund të kenë dëmtim organesh në rast hiperkalçemie. Gjatë terapisë me vitaminë D duhet të monitorohet përqëndrimi plazmatik i fosfateve, në mënyrë që të shmangët rreziku i kalçifikimit ektopik. Gjithashtu, pacientët që marrin doza farmakologjike të vitaminës D, duhet të monitorojnë përqëndrimin plazmatik të kalciumit në intervale të rregullta kohe, kryesisht në fillim të trajtimit dhe në rastin e një toksiciteti të dyshuar. Fëmijët të cilët ushqehen me gjë nga nëna të cilat marrin doza farmakologjike të vitaminës D, duhet të monitorohen.

Marrja e barnave të tjera:

- Neomicina, bleomicina, kolestiramina dhe parafina e lëngët mund të reduktojnë në mënyrë të dukshme përthithjen e vitaminës A.
- Në qoftë se acitretina, tretionina ose izotretionina merren në të njëjtën kohë me vitaminën A, mund të ndodhë një gjendje e ngjashme me mbidozën nga vitamina A.
- Konsumimi i lartë i alkoolit mund të rrisë nivelet e beta - karotenit dhe në këtë mënyrë të preket metabolizmi i vitaminës A.
- Pacientët që kanë marrë njëkohësisht doza të larta të vitaminës D dhe diuretikë (si p.sh. tiazidët, të cilët mund të reduktojnë eliminimin e kalciumit me anë të urinës), mund të zhvillojnë hiperkalçemi dhe ndoshta edhe alkalozë metabolike.
- Përdorimi për një kohë të gjatë i fenitoinës, fenobarbitalit, ose primidonit mund të çrregullojë metabolizmin e vitaminës D dhe kalciumit dhe mund të shkaktojë osteomalaci.
- Rifampicina dhe izoniazidi mund të reduktojnë efektin e vitaminës D.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gjë

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar. Vitaminat A dhe D e kalojnë placentën dhe ekskretohen me qumështin e gjirit. Për shkak të potencialit teratogjen dhe toksik që këto vitamina paraqesin nëse merren në doza të larta, përdorimi i tyre mund të bëhet vetëm në rastet kur jua këshillohet mjeku.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk janë vënë re efekte mbi aftësinë për të drejtuar automjete dhe për të përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI ADVIT

Gjithmonë merreni Advit sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin.

Dozimi i Advit është individual.

Dozimi ditor i rekomanduar për fëmijët është si më poshtë:

- deri në 1 vjeç: 5 pika;
- 2 – 5 vjeç: 5 – 10 pika;
- 6 – 12 vjeç: 5 – 10 pika.

Pas 14 ditësh këshillohet një pushim prej 1 – 2 javësh.

Pikat përdoren menjëherë para ngrënies, të vetme ose të hedhura në një lugë çaji me qumësht. Në qoftë se ushqimi përmban sasi të pamjaftueshme proteinash dhe yndyre, kërkesat për vitaminë A rriten. Foshnjat e lindura para kohe dhe foshnjat me çrregullime të tretjes (sindromë keqpërthithjeje) kanë nevojë për doza më të larta.

Dozimi ditor për të rritur është si më poshtë:

- 10 – 20 pika 1-2 herë në ditë.

1 pikë ADVIT = 250 UI vitaminë A dhe 250 UI vitaminë D.

Në qoftë se keni marrë më shumë Advit

Në qoftë se keni marrë më shumë Advit se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Advit

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

4. EFЕКTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Advit mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e trajtimit. Në dozat e rekomanduara, praktikisht nuk ekziston rrezik për efekte të padëshirueshme. Si rezultat i mbidozimit mund të shfaqet hipervitaminozoza. Shenjat fillestare të hipervitaminozës janë: fontanelë e tendosur, etje, poliuri, të përziera, anoreksi, të vjella, tharje lëkure, heqje në trajtë luspash e lëkurës së pëllëmbëve të duarve dhe shputave të këmbës, kruarje, dhimbje e kockave dhe e artikulacioneve. Ekziston edhe mundësia e reaksioneve të mbindjeshmërisë, por janë shumë të rralla. Mjekimi duhet ndërprerë në qoftë se shfaqen shenjat e hipervitaminozës ose të reaksioneve të mbindjeshmërisë.

5. SI TA RUANI ADVIT

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e ruani mbi 25°C. Mos e përdorni Advit pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim. Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Advit

Lëndët aktive janë vitaminë A (retinol) dhe vitaminë D (ergokalçiferol).

1 mL tretësisirë me pika për gojë përmban 10,000 UI vitaminë A dhe 10,000 UI vitaminë D.

Lëndët ndihmëse janë: butilhidroksitoluen, butilhidroksianisol, vaj ulliri i rafinuar.

Përmbajtja e paketimit:

kuti me një shishe plastike 20 mL.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:



PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

